



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës  
Opština Priština –Municipality of Prishtina



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d e Ligjit nr. 03/L – 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), neneve 19, 22 dhe 28 të Udhëzimit administrativ (MAPL) nr. 04/2023 për administratë të hapur në komuna, nenit 32, pika c dhe nenit 34, paragrafi 34.1, shkronja d të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, dt. 25.2.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më 31.3.2026, merr këtë

**V E N D I M**  
**PËR VËNIEN NË DISKUTIM PUBLIK**

1. Miratohet fillimi i procedurave për vënien në diskutim publik për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores, 01. Nr. 110-2782, më 02.12.2011, për tarifa, ngarkesa dhe gjoha komunale.
2. Organizimi i diskutimit publik do të bëhet sipas Udhëzimit administrativ (MAPL), nr. 04/2023 për administratë të hapur në komuna.
3. Sipas pikës 1 të këtij Vendimi, diskutimi publik do të zgjatë 15 ditë kalendarike, nga data e shpalljes së njoftimit publik për mbajtjen e konsultimeve.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Kryeqytetit, respektivisht zyrtari përgjegjës për koordinimin e konsultimit publik.
5. Ky Vendim hyn në fuqi 30 (tridhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Kryeqytetit.

**KUVENDI I KRYEQYTETIT**  
01-431/04-48105/26, më 02.4.2026

**KRYESUES I KUVENDIT**  
Fehmi Kupina,

